PREFEKTURA DIBËR
Arkiva
Nr. 335 dt. 10.3.23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 1006 Prot    Peshkopi, më 09.03.2023

**Lënda:** Dërgim vendimi

**Drejtuar:** Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër **Nr.25**

**Datë: 03.03.2023**

**"Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare z.Bilal Fida"**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

**Afrim Mikli**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DIBËR

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, email: bashkiadiber@gmail.com tel: 0035521822935

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# PREFEKTI I QARKUT DIBËR

**Nr.335/1 prot.** **Peshkopi, më 17.03.2023**

**Lënda**: Për vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër.

**BASHKISË**

**DI B Ë R**

Në mbështetje të nenit 16-të të ligjit nr.107 datë 27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin nr.25 (njëzetepesë) datë 03.03.2023, të Këshillit të Bashkisë Dibër,''Për akordim fondi në mbulimin e dëmit financiar nga emergjencat civile, për dëmtim banese nga faktorët natyror apo njerëzor", **vendosa**:

Miratimin në parim të kësaj vendimmarrje në kushtet e respektimit të legjislacionit aktual në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e së drejtës.

Duke ju falenderuar për mirkuptimin.

**P R E F E K T I**
**Nexhbedin SHEHU**

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, Albania Tel. & Fax ++355 2182 2631 adres e-mail prefekturadiber@gmail.com

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DIBËR**
**KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

# VENDIM

**Nr.** 25 **Datë** 03/03/**2023**

**" Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare"**

Në mbështetje të **Ligjit Nr. 139 datë 17. 12. 2015** " *Për vetqeverisjen vendore*", **Ligjit Nr. 107 datë 22. 10. 2016** " Për Prefektin e Qarkut ", **Ligjit Nr. 45 datë 18. 07. 2019** " *Për Mbrojtjen Civile*", **VKM Nr. 329 datë 16. 05. 2012** " *Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*" **kreu III, pika 1, gërma ë,** dhe **kreu III, pika 3, gërma ç,** Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **03.03.2023** me 18 vota pro, 1 kundër dhe 0 apstenim:

**VENDOSI :**

I. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor.

II. Të njohë vlerën totale të dëmit për objektin **shtëpi banimi 1 kat** në pronësi të **z. Bilal Fida** njësia administrative Melan ( fshati Begjunec ) në shumën totale **1776842** lekë sipas dokumentacionit të paraqitur nga ana e komisionit për këtë qëllim. Nga kjo vlera e dëmit ndërtimor **1606042** lekë dhe vlera e dëmit orendiak **170800** lekë.

III. Nga fondi emergjencave civile të bashkisë Dibër të trajtohet i dëmtuari në shumën prej **888421** lekë ( 50 % të vlerës totale të dëmit ) për ti përdorur për riparimin e dëmit të shkaktuar.

IV. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.

V. Vendimi u shpall me datë **03.03.2023.**

**Kryetar Këshilli**

**Sokol Sava**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DIBËR

Adresa: Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, email: bashkiadiber@gmail.com tel: 0035521822935

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DIBER**
**DREJTORIA PPECK**

*Nr. 574/1 prot.* *Peshkopi, më 20.02. 2023*

**PROJEKT - VENDIM**
" Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare"

Në mbështetje të **Ligjit Nr. 139 datë 17. 12. 2015** " *Për vetqeverisjen vendore*", **Ligjit Nr. 107 datë 22. 10. 2016** " Për Prefektin e Qarkut ", **Ligjit Nr. 45 datë 18. 07. 2019** " *Për Mbrojtjen Civile*", **VKM Nr. 329 datë 16. 05. 2012** " *Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*" **kreu III, pika 1, gërma ë**, dhe **kreu III, pika 3, gërma ç,** në mbledhjen e tij,

**VENDOSI :**

I. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor.

II. Të njohë vlerën totale të dëmit për objektin **shtëpi banimi 1 kat** në pronësi të **z. Bilal Fida** njësia administrative Melan ( fshati Begjunec ) në shumën totale **1776842** lekë sipas dokumentacionit të paraqitur nga ana e komisionit për këtë qëllim. Nga kjo vlera e dëmit ndërtimor **1606042** lekë dhe vlera e dëmit orendiak **170800** lekw.

III. Nga fondi emergjencave civile të bashkisë Dibër të trajtohet i dëmtuari në shumën prej **888421** lekë ( 50 % të vlerës totale të dëmit ) për ti përdorur për riparimin e dëmit të shkaktuar.

IV. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Institucioni Prefektit Qarkut Dibër për bazueshmërinë ligjore.

**PËR BASHKINË DIBËR**

**DREJTORI PPECK**
Hazbi KAMBERI

**PËRGJEGJËSI SEKTORIT JURIDIK**
Elona LUSHA

**DREJTORI EKONOMIK**
Mensur SHEHI

**KRYETARI BASHKISË**
Rahim SPAHIU

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DIBER

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DIBER**

**DREJTORIA PPECK**

**Lënda :** Relacion shpjegues në lidhje me vlerën e dëmeve të llogaritura të banesës që ka pësuar aksident ( rrjedhje gazi, shpërthim ) për z. Bilal Fida me banim në fshatin Begjunec nj/adm. Melan.

Për Këshillin Bashkiak Dibër

Bazuar në ligjin 139/2015 " *Për Vetqeverisjen Vendore*", ligjin 45/2019 " *Për Mbrojtjen Civile*", VKM nr. 329/2012 " *Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*", për rastin e aksidentit ( rrjedhje gazi, shpërthim ) në banesën 1 kat të z. Bilal Fida, me banim në fshatin Begjunec njësia administrative Melan, ju sqarojmë se është verifikuar rasti nga komisioni i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Dibër, janë bërë matjet e duhura, është bërë fotografimi i objektit brenda e jashtë, është bërë vlerësimi i dëmit në përputhshmëri me kërkesat e VKM nr. 629/2015 " Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" dhe EKB ( dokumentit të sjellë nga Ministria Brendshme me nr 5163 prot datë 14. 08. 2017 protokolluar në bashki me nr 3891 prot datë 17. 08. 2017 " *Çmimet mesatare sipas zërave të punës*" ) si dhe listës së çmimeve të orendive e pajisjeve elektroshtëpiake të sjella nga Institucioni Prefektit Qarkut Dibër me nr. 20/1 datë 11. 01. 2022, protokolluar në bashki me nr. 24/1 datë 13. 01. 2022 dhe ka si dokument shoqërues shkresën e sjellë nga Ministria Brendshme me nr. 565/8 datë 12. 05. 2016 " *Çmimet aktuale mesatare të mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria Përgjithshme e tatimeve*" .
Dokumentacioni tekniko – ligjor është bashkëlidhur në dosje bazuar në VKM nr. 329/2012 " *Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*".

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**DREJTORI PPECK**

**Hazbi KAMBERI**

*Peshkopi 20. 02. 2023*

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DIBËR**

**U R D H Ë R**

**Nr. 93 datë 10.02.2023**

**" PËR NGRITJE KOMISIONI PËR VERIFIKIM NË TERREN ".**

**Në zbatim të VKM nr. 329 datë 16.05.2012 "***Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore***", kreu III, pika 1, gërma b,**

*U r dh ë r o j:*

1. Të ngrihet komisioni pranë Bashkisë Dibër për zbatimin e VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 "*Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*", kreu III, pika 1, gërma b, me këtë përbërje :

   a. **Kryetar komisioni** z. EDVIM SHAHI
   b. **Anëtar komisioni** z. ANDON SINA
   c. **Anëtar komisioni** z. RAMAZAN TEMA

2. Ky komision do të bëjë verifikimin në vend dhe mbajë proçes-verbalin e konstatimit të gjendjes për dëmet e shkaktuara :
   në objektin SHTEPI BANIMI,
   në pronësi të z.~~zj~~ BILAL FIDA,
   me banim në fshatin/la~~gjen~~ BEGJUNEC,
   Njësia administrative MELAN,
   **si rezultat i fatkeqësisë natyrore** AKSIDENT (RRJEDHJE GAZI).

3. Të përgatisë preventivat e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara në objektin e banimit sipas përcaktimeve të bëra në VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 dhe vlerësimin për orenditë, mobiljet dhe pajisjet elektro-shtëpiake të dëmtuara në objektin e banimit sipas VKM Nr. 329 datë 16.05.2012
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I BASHKISË**

**Rahim SPAHIU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DIBËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

# PROCES-VERBAL KONSTATIMI

I mbajtur sot me date **12.02.2023** ne fshatin BEGJUNEC, ne Njesine Administrative **MELAN** ,ne banesen njekateshe+bodrum te **z.Bilal Fida**(ne katin perdhe dhe ne bodrum), mbi verifikimin e kerkeses se tij te dates **10.02.2023** drejtuar **Bashkise Diber**.

Ne zbatim te **VKM se nr 329** date **16 05 2012**(Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtari njerezore), **kreu III, pika 1,germa b** si dhe ne zbatim te **Urdherit te Kryetarit te Bashkise nr.93** te dates **10.02.2023** ,per ngritjen e komisionit per verifikimin e pasojave te shkaktuara nga rrjedhja e gazit , ku ky komision perbehet nga ana e kryetarit **Ing Edvin Shahi** si dhe anetaret **Ramazan Tema** dhe **Andon Sina**

Objekti I z.Bilal Fida perbehet nga keto elemente struktural , si **cati** me tjegull marsejeze, **mure** guri mbajte dhe ndares ,**suva** e brendshme e tavanit dhe e mureve me llac cimento , **suva** e jashtme e mureve me llac cimento, **dysheme** me lluster cimentoje, **pllaka** te dyshemese se dhomave dhe te banjos porcelanat importi , **pllaka** te veshjes se banjos qeramike ,**dera** e brendshme tamburato, **2 dyer** te jashtme prej duralumini dopio xham, **2 dritare** te jashtme duralumini, **tavane** me korniza prej allcie,**linja** elektrike inkaso, **dhe linja** hidraulike inkaso .

Nga verifikimi ne vend i objektit u konstatua se jane te demtuar nga veprimtaria natyrore e llojit rrjedhje nga gazi elementet strutural te meposhtem: **catia** me tjegull marsejeze ne dy te treten e siperfaqes s esaj si rezultat I prishjes se struktures se **mureve** te bodrumit dhe te katit perdhe ,**suvaja** e brendshme e mureve me llac cimento , **suva** e jashtme e mureve me llac cimento, **dyshemeja** me lluster cimentoje, **pllakat** e dyshemese se dhomave dhe te banjos gres porcelanat , **pllakat** e veshjes se banjos qeramike ,**dera** e brendshme tamburato, **1 dere** e jashtme prej duralumini dopio xham, **2 dritare** te jashtme duralumini rreshqitese, **tavane** me korniza prej allcie,**linja** elektrike inkaso, **dhe linja** hidraulike inkaso

Deme orendiake jane gjithashtu ne elementet e meposhtem: **Lavatrice,frigorifer,sobe gatimi me gaz, set enesh guzhine, set divanesh,kolltuqe,televizor,,bombul gazi bashke me ingranazhet e saj** si rezultat i rrjedhjes se gazit.

**Per te parandaluar eleminimin e metejshem te rrezikut te degradimit te elementeve te kesaj ndertese , eshte e domosdoshme te merren masa parandaluese per nderhyrje ne elementet e demtuar sipas projekt-preventivit qe do te hartohet nga grupi i eksperteve.**

Demtimet e mesiperme evidentohen nga fotot e bera ne vend.

**Ky proces verbal mbahet ne 5 kopje dhe nenshkruhet nga komisioni.**

KOMISIONI I KONSTATIMIT

| Kryetar | Anetar | Anetar |
|---|---|---|
| Ing.Edvin SHAHI | Ramazan TEMA | Andon SINA |

## PLANIMETRIA E OBJEKTIT TE QYTATARIT Z.BILAL FIDA

**SHKALLA 1:100**




PUNOI: ING EDVIN SHAHI

PESHKOPI ME 17.02.2023

MIRATOHET
BASHKIA DIBËR
KRYETARI
Z. RAHIM SPAHIU

PREVENTIV I OBJEKTIT:

Deme te shkaktuara nga rrjedhja e gazit ne banesen e qytatarit z.Bilal Fida (Objekt 1kat)
Nj.Admin. Melan,Fshati Begjunec(Aksident rrjedhje gazi me date 10.02.2023 )

| Nr | Nr.Anal. | Emertimi i Punimeve | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | A. KATI PERDHE | | | | |
| 1 | 219 | Cati vendi hd deri 8 m,tj marsejeze pa lluster | m2 | 108 | 2491 | 269.028,00 |
| 2 | 54./1 | Mure guri lartesi llac cimento M15 | m3 | 46 | 7034 | 323.564 |
| 3 | 293 | Suva tavani res kallami h~4m | m2 | 74 | 1911 | 141414 |
| 4 | 2.312 | Suva br. mur guri h~4m , llaç per. M 25 | m2 | 220 | 737 | 162140 |
| 5 | 340 | Suva jashte mur guri gervishtje dhe larje | m2 | 54 | 1296 | 69984 |
| 6 | 262/1 | Shtrese dyshemeje betoni C7/10 | m3 | 12 | 7527 | 90324 |
| 7 | 2.267/a | Shtrese me pllaka grez porcelanat ne wc | m2 | 84 | 2198 | 184632 |
| 8 | An27 | Veshje me pllake qeramike ne wc | m2 | 36 | 4492 | 161712 |
| 9 | 2.330 | Patinim tavani allci+stuko | m2 | 78 | 387 | 30186 |
| 10 | AN.4 | F.v dyer te brendshme tamburato te thjeshta | m2 | 3,2 | 9725 | 31120 |
| 11 | AN.3 | F.v dyer te jashtme duralumini dopio xham | m2 | 2,8 | 10626 | 29752,8 |
| 12 | An1 | F.v dritare duralumini rreshqitese tek xham | m2 | 3 | 8200 | 24600 |
| 13 | 495 | F.v lavaman cilesi e dyte bashke me grupin | cope | 1 | 7993 | 7993 |
| 14 | 508/a | F.v pjate dushi porcelani | cope | 1 | 7159 | 7159 |
| 15 | 502 | F.v wc cilesi e II+kasete shkarkimi | cope | 1 | 8283 | 8283 |
| 16 | 480/1 | F.v tuba plasmasi diam=18-21 mm | ml | 298 | 94 | 28012 |
| 17 | 481/2 | F.v percjelles PV-500 me s=2.5mm2 | ml | 168 | 39 | 6552 |
| 18 | An.40 | F.v celesa elektrik devijat | cope | 6 | 466 | 2796 |
| 19 | 485 | F.v priza me nilifikim | cope | 10 | 465 | 4650 |
| 20 | An.15 | Kuader me 5 automate +1 celes | cope | 1 | 6132 | 6132 |
| 21 | 399 | Bojatisje me gelqere pa pigment | m2 | 348 | 46 | 16008 |
| | | **Shuma A.** | | | | **1.606.042** |
| | | | | | | |
| | **TOTALI** | **A** | | | | **1.606.042** |

PREVENTIVOI Ing Edvin SHAHI

SHENIME: Cmimet jane sipas VKM-se Nr=629 date 13.05.2015, dhe sipas EKB

PESHKOPI ME 20 .02..2023

**MIRATOHET**
**KRYETARI**
**RAHIM SPAHIU**

**PREVENTIV**

**Objekti:** Rivlerësimi i orendive Elektroshtëpiake në banesën e Bilal Fida,fshati Bugjenec Nj.Ad.Melan.Bashkia Dibere dëmtuar aksidentalisht nga rrjedhja e gazit më 10.02.2023

| NR | EMËRTIMI | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Frigorifer | cope | 1 | 55000 | 55000 |
| 2 | Lavatriçe | cope | 1 | 36000 | 36000 |
| 3 | Sobë elektrike | cope | 1 | 29000 | 29000 |
| 4 | Sobë me gaz gatimi | cope | 1 | 27000 | 27000 |
| 5 | Divan | cope | 1 | 10000 | 10000 |
| 6 | Tavolin buke | cope | 1 | 6000 | 6000 |
| 7 | Karrike te zakonshme | cope | 6 | 1300 | 7800 |
| | **Totali** | | | | **170800** |
| | | | | | |

**PREVENTIVOI :** **Andon SINA**

**Shënim :** Vlersimi I orendive,mobiljeve dhe paisjeve elektro-shtëpiake të dëmtuara eshtë berë mbibazën e çmimeve aktuale të përcaktuara nga DPT.

**PESHKOPI ME 20.02.2023**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

# KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT
# TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur i është adresuar Bashkisë Dibër nga ____________________ dhe mban nga dërguesi nr____ prot datë.____.202_ me trajtë të shkurtuar të përmbajtjës( lënda)____________________

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr.hyrës prot______datë ____.____.202__.

Praktika u drejtohet për administrim:

-Znj/Z____
-Znj/Z____ Dylonse Preçe
-Znj/Z____
-Znj/Z____

me porosinë: ____ Administrohu praktikën sipas ligjit

Afati i përgatitjes së praktikës shkresore( përgjigjes,..etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar do të jetë ____ sipas afateve

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore: ____

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS

Peshkopi, në ___.____.202___

DT 10. 02. 202

BASHKIA PESHKOPI
Nr 574 Prot
Datë 10/02/23

BASHKIA PESHKOPI
Nr 574 Prot
Datë 10/02/23

# Kërkesë

Drejtuar : Bashkia Dibër

Unë i nënshkruari Bilol Fida, lindur dhe banues në Bugjenec, paraqes kërkesën time për ndihmë financiare. Dje më ka plasur bombulo e gazit në shtëpi, dhe më ka dëmtuar shumë shtëpinë. Si pasojë e shpërthimit të bombulës së gazit është djegur edhe nusja e djalit, është në gjendje të rëndë për jetën. Pasi është djegur gati 45% e trupit. Ju lutem të na ndihmoni pasi jemi pensionista dhe s'kemi të ardhura tjera, përveç djalit që punon me sezone në Greqi - Mbetem në shpresën që kërkesa ime do të merret parasysh

Me respekt
Bilol Fida

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Dibër

Njësia administrative Melan

Zyra e Gjendjes Civile 41

Datë: 16.02.2023

# CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

| Nr. | Emri e Mbiemri | Emri i Babait | Emri i Nënës | Gjinia | Lidhja me K. Familjarin | Datëlindja | Gjendja Civile | Vendlindja | Shtetësia | Numri Personal |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Bilal FIDA | Muharem | Peme | M | Kryefamiljar | 10-12-1949 | I/e martuar | Begjunec, Dibër | Shqiptare | E91210001K |
| 2. | Florina FIDA | Ramadan | Hafize | F | Bashkëshorte | 20-07-1958 | I/e martuar | Deshat, Dibër | Shqiptare | F85720237D |
| 3. | ---------------- | | | | | | | | | |
| 4. | ---------------- | | | | | | | | | |
| 5. | ---------------- | | | | | | | | | |
| 6. | ---------------- | | | | | | | | | |
| 7. | ---------------- | | | | | | | | | |
| 8. | ---------------- | | | | | | | | | |
| 9. | ---------------- | | | | | | | | | |
| 10. | ---------------- | | | | | | | | | |

Kjo certifikatë lëshohet për ______________________

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
Date:2023/02/16 09:47:28 +02'00'
415463202302160947207001001



Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile)






























REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

## KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur i është adresuar Bashkisë Dibër nga PQDibrv. dhe mban nga dërguesi nr 335/1 prot datë 17.03.2023 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes( lënda)

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr.hyrës prot 120/6/1 datë 20.03.2023.

Praktika u drejtohet për administrim:

-Znj/Z

-Znj/Z Sekretarit të Këshillit Bashkiak

-Znj/Z

-Znj/Z

me porosinë: Administroni praktikën sipas ligjit

Afati i përgatitjes së praktikës shkresore( përgjigjes,..etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar do të jetë sipas afatave

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore:

Peshkopi, më 20.03.2023

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS